VENDIM
Nr. 1006, datë 2.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 945, DATË 2.11.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES 'ADMINISTRIMI I SISTEMIT TË BAZAVE TË TË DHËNAVE SHTETËRORE'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 945, datë 2.11.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit si autoriteti rregullator koordinues i bazave të të dhënave shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.".

2. Në tekstin që i bashkëlidhet vendimit bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 2, e nenit 1, "Qëllimi i administrimit të sistemit të bazave të të dhënave shtetërore", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Kjo rregullore zbatohet për bazat e të dhënave që ruajnë dhe/ose përpunojnë informacion të klasifikuar "sekret shtetëror", në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", duke përjashtuar institucionet e inteligjencës.".

b) Pas nenit 8, shtohet neni 8/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 8/1
Krijimi dhe regjistrimi i bazës së të dhënave shtetërore

Çdo institucion publik, i cili administron vetë ose nëpërmjet palëve të treta një bazë të dhënash shtetërore dhe është rregullator epror i sektorit përkatës, dhe çdo person juridik publik dhe privat, që ushtron funksion publik, nxjerr aktin e krijimit të bazës së të dhënave shtetërore, në përputhje me nenin 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga dita e parë e mbledhjes së të dhënave në mënyrë manuale.".

c) Në nenin 14 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

i. Në pikën 1, fjalët "… Sistemi i ndërveprimit të bazave …" zëvendësohen me fjalët "… Ndërveprimi i bazave …".

ii. Pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

"3. Çdo bazë e të dhënave shtetërore vendos në dispozicion të dhënat parësore në platformën e ndërveprimit dhe merr prej saj të dhëna dytësore të vendosura në dispozicion nga baza të tjera të të dhënave shtetërore, kur ato ekzistojnë, gjë që duhet të reflektohet dhe në strukturën e bazës së të dhënave.".

ç) Neni 15 shfuqizohet.

d) Neni 16 shfuqizohet.

dh) Pas nenit 16, shtohet neni 16/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 16/1
Masat administrative për shkelje të rregullave të regjistrimit nga subjektet administruese të bazave të të dhënave

Mosdorëzimi i dokumentit tekniko-ligjor brenda afatit të përcaktuar në këtë rregullore për regjistrimin e bazës së të dhënave ose regjistrimin e ndryshimeve të bazës së të dhënave shtetërore ekzistuese përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas parashikimit të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, 'Për bazat e të dhënave shtetërore'.".

e) Në nenin 24, pas pikës 4, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

"5. Refuzimi i institucionit për të bashkëpunuar për përcaktimin e personit të kontaktit ose për kryerjen e auditimit përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas parashikimit të pikës

1, të nenit 11, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, 'Për bazat e të dhënave shtetërore'.".

ë) Në nenin 27 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Institucionet, të cilat kanë krijuar dhe/ose janë në proces krijimi, të një ose më shumë bazash të dhënash shtetërore, nxjerrin aktin e krijimit të bazës së të dhënave shtetërore, në përputhje me nenin 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.".

ii. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Institucionet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, brenda 20 (njëzet) ditëve nga miratimi i aktit të krijimit të bazës së të dhënave shtetërore, dorëzojnë dokumentacionin për regjistrimin e saj pranë ARK-së, në përputhje me nenin 9, të këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe